



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË
TË STUDIMEVE UNIVERSITARE NË FRANCË,
VITI AKADEMIK 2018-2019**

Në kuadrin e Bashkëpunimit Kulturor, Ambasada e Republikës së Francës në Tiranë njofton se për kandidatët e huaj që dëshirojnë të studiojnë në Francë ka filluar fushata e pararegjistrimit 2018-2019 në ciklin e parë të studimeve (universitete dhe në shkollën e lartë kombëtare të arkitekturës).

Procedura e aplikimit:

Materialet e aplikimit për pranimin paraprak mund të tërhiqen pranë zyrave të Shërbimit, të Bashkëpunimit dhe Veprimtarive Kulturore të kësaj Ambasade, duke filluar nga data deri 27 nëntor 2017, çdo ditë, nga e hëna në të enjte, ora 14:30-17:00. Pasi të kenë plotësuar dokumentacionin, kandidatët duhet t'i dorëzojnë dosjet përkatëse në Ambasadë duke filluar nga data 11 dhjetor 2017 deri në 21 dhjetor 2017, ose nga data 08 janar 2018 deri në 19 janar 2018 që është dhe afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve (nga e hëna deri të enjten, midis orës 14:30 dhe 16:30 dhe të premten nga ora 10:00 deri në orën 12:00).

Mbas dorëzimit të dokumenteve, kandidatët duhet të provojnë se kanë nivelin B2 të frengjishtes nëpërmjet DELF-it ose TCF DAP. Lidhur me kete kriter, kandidatët që nuk kanë nivelin gjuhësor DELF B2 dhe TCF DAP do t'i nënshtrohen një provimi për njohjen e gjuhës frënge (TCF), i cili do të organizohet në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në datën 08 shkurt 2018, nga ora 9:00-13:00. Nxënësit e seksioneve dygjuhëshe frankofone përjashtohen nga testi gjuhësor. Në momentin e dorëzimit të dosjes së regjistrimit, çdo kandidat që do të kalojë testin TCF DAP duhet të paguajë pranë Ambasadës Franceze në Tiranë një tarifë prej 69 EURO.

Për më tepër informacion mbi procedurën e regjistrimit paraprak (e cila realizohet në gjuhën frënge), kandidatët shqiptarë duhet t'i referohen adresave online në vijim:

<https://al.ambafrance.org/Procedurat-e-regjistrimit-ne-vitin-e-pare-te-ciklit-te-pare-te-studimeve>;

<https://al.ambafrance.org/-Etudes-en-France>;

e-mail: valbona.nano@diplomatie.gouv.fr;

Tel: 042389700

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Tel: +355 4 42230244 Fax : +355 4 42230244

Email: info@arsimi.gov.al

Web site: www.arsimi.gov.al